

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr 457/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej Kimete Gashi-Kryetare, Vedat Poterqoi- Anëtar si dhe Agon Ramadani- Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Gashi EG” & “Ibrahim Kurrumeli” – Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit: “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 5 Lote” – LOT 2 dhe LOT 4 me nr te prokurimit: 613-22-5709-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna Lipjan, më datën: 06. 10. 2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** pajtimi i palëve për ankesën 457/22 të datës 12. 09. 2022 lidhur aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 5 Lote” – LOT 2 dhe LOT 4 me nr te prokurimit: 613-22-5709-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna Lipjan.
- II. **OBLIGOHET** AK- KK Lipjan që aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 5 Lote” – LOT 2 dhe LOT 4 me nr te prokurimit: 613-22-5709-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna Lipjan, konform raportit të ekspertit shqyrtues teknik me të cilin AK është pajtuar ta kthejë në **RIVLERËSIM**.
- III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

- IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.
- V. Me qenë se OE ankues është pajtuar me rivlerësim të aktivitetit të prokurimit dhe sipas raportit të ekspertit ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Me datën: 12. 09. 2022, OE ankues “Gashi EG” & “Ibrahim Kurrumeli” – Lipjan, si palë e pakënaqur ka parashtruar ankesë me nr: 457/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 5 Llote” – LOT 2 dhe LOT 4 me nr te prokurimit: 613-22-5709-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna Lipjan.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.09.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 29.09.2022, në raportin e ekspertizës ka deklaruar:

Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues për LOT 2, për pozicionin nr.2 Furnizimi dhe deponimi i kryes dhe rërës një muaj para sezonit dimëror, matja e sasisë, para organit mbikëqyrës ne deponi, ku AK ne paramase e ka kalkuluar 177,660 kg, ku AK e ka anuluar OE ankues me arsyetimin se ka bere gabim aritmetik ne llogaritje, me shume se 2% e vlerës se kontratës.

Pra, AK e ka eliminuar OE ankues, me arsyetimin se nuk e ka plotësuar siç duhet përshkrimin e çmimeve.

Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, lidhur me paramasen, sqaron si ne vijim:

Prove:

Poz.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi per 1 (një) herë e hudhjes se kripes per (m ²)	Çmimi per 20 (njëzetë) herë e hudhjes se kripes per (m ²) per 1 vit	Shuma e përgjithëshme per 2 vit
2	Furnizimi dhe deponimi i kypës dhe tëres një muaj para sezonit dimërorë ,matja e sasisë	Kg	177,660	0.0800	710.64	14,212.80	28,425.60



4/8

	para organit mbikqyres në deponi						
Sqarim i llogaritjes		a	b	c=a*b/20	d=a*b	e=d*2	

Ne fund te tabelarit shihet se si e ka llogaritur çmimin OE ofertues.

Sipas këtij tabelari siç pretendon edhe OE ankues, çmimin për njësi nuk e ka vendosur për një (1) shërbim, por për 20 shërbime, sepse nga llogaritja del kështu, kurse nëse pjesëtohet për 20 shërbime del rezultati 0.0004, qe është i njëjtë çmimi me OE te rekomanduar për kontrate. Por mënyra e llogaritjes është me ndryshe se OE i rekomanduar.

Sipas kësaj formule e ka llogaritur pozicionin nr.2 OE ankues.

$C = A * B / 20$; $d = a * b$, kurse $e = d * 2$

Atëherë, kemi

$C = A * b$ kalkulim: $177,660 \text{ kg} * 0.0800 / 20 = 710.64 \text{ €}$;

$D = a * b$ kalkulim: $177,660 \text{ kg} * 0.08 = 14,212.80 \text{ €}$

$E = d * 2$ kalkulim: $14,212.80 * 2 = 28,425.60 \text{ €}$

Kurse OE i rekomanduar RSM ka kalkuluar sipas kësaj formule

$A * b = c$

$C * 20 = d$

$E = d * 2$

Kurse OE i rekomanduar ka vendosur këtë çmim ne pozicionin nr.2, qe si total del i njëjte me vlerën e OE se rekomanduar, por OE i rekomanduar e ka vendosur çmimin për një shërbim, e jo si OE ankues e ka vendosur çmimin për 20 shërbime.

Shih tabelarin e OE te rekomanduar për LOT 2;

Ne pozicionin nr.2

Pra, dallimi është se OE i rekomanduar ka vendosur çmimin për njësi 0.004, kurse OE ankues ka dhënë çmimin për njësi 0.08

Pra, dallimi është këtu se OE ankues ka vendosur çmimin njësi për 20 shërbime, kurse OE i rekomanduar për 1 shërbim.

Sipas specifikimit të detyrueshëm teknik AK e ka përdorur kalkulimin për vit, por nuk e ka përdorur për 2 vite, kjo ka mund të shkaktoj huti të OE pjesëmarrës gjatë plotësimit të dosjes.

Specifikimi teknik si model AK e ka bërë kalkulimin e vlerës së rrugëve në këtë mënyrë

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lindore në Komunën e Lipjanit-

Loti-2 për vitin 2022-2024

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lindore në Komunën e Lipjanit-

Loti-2 për vitin 2022-2024

Punë të planifikuara							
Përshkrimi i rrugëve	Gjatësi (m')	Gjerësia m	Si përfaqja - me asfalt m ²	Sasia e hudhjes së kripës kg/m ²	Ditë të planifikuara me reshje për hedhje të kryes	Sasia e hudhjes së kripës në (Kg) m ² ditore	Sasia e hudhjes së kripës kg/m ² për 20 ditë
Hekurudhe-Kojak	5510	5	27550	0.020	20	551	11020
Rubovc i Vogël	1300	4	5200	0.020	20	104	2080
Rubovc i Madhë	3500	4	14000	0.020	20	280	0
Llugaxhi-Rubovc	4500	5	22500	0.020	20	450	9000
Gomnasellë	3000	4	12000	0.020	20	240	4800
Banullë	9000	5	45000	0.020	20	900	18000
Glllogovcë	6000	5	30000	0.020	20	480	9600
Sllovijë	7500	4	30000	0.020	20	600	12000
Sllovijë-Terbovc	5000	5	25000	0.020	20	500	10000
Smallushë	6900	5	34500	0.020	20	690	13800
Qallapek	1200	4	4800	0.020	20	96	1920
Gadime e Ultë-e Eperme	15000	5	75000	0.020	20	1500	30000

Babushë i Muhagjerve	5500	5	27500	0.020	20	550	11000
Vrellë e Gadimes	7500	4	30000	0.020	20	600	12000
Vrellë Plitkoviq	5000	4	20000	0.020	20	400	8000
Marevc- Gllavicë	2900	4	11600	0.020	20	232	4640
Gadime - Smallushë	3500	4	14000	0.020	20	280	5600
Gad e Eperme- Gllavicë	3500	4	14000	0.020	20	280	5600
Shtigjet e Ecjes- Gadime	1500	5	7500	0.020	20	150	3000
TOTALI	97810		450150.0			8883	177660

AK ne specifikimin e detyrueshëm teknik e ka vendosur kalkulimin ne këtë mënyrë:

Gjatësia e rrugës x gjerësia e rrugës = sipërfaqja me asfalt (m2) x sasia e hudhjes se kripës (kg/m2) = Sasia e hudhjes se kripës (kg/m2) ditore x ditët e planifikimeve me reshje për hedhje te kripës(20 dite) = Sasia e hudhjes se kripës (kg/m2) për 20 dite.

Mendoj se kjo ka mund te shkaktoj huti tek Operatorët gjate vendosjes se çmimeve ne tabelarin e çmimeve dhe ka mundur të bëhet më thjeshtë.

Pra, krahasimi është se dy OE kane çmimet totale te njëjta për LOT 2 si OE ankues por edhe i rekomanduar, por dallimi është se OE ankues çmimin njësi e ka te kalkuluar për 20 shërbime (për 1 vit), kurse OE i rekomanduar për 1 shërbim.

Pra, siç pretendon OE ankues se sasia e kripës qe duhet te shpenzohet për 1 here është 8883 kg, e jo 177,660 kg, sepse kjo shume është për 20 here, e nuk është për 1 here.

Eksperti i OSHP-se i ka kërkuar sqarime AK-se për disa paqartësi

Lidhur me pretendimet ankimore te OE ankues se AK një here i ka kërkuar dokumentet para dhënies OE ankues, por pas disa dite i ka shpërblyer dy OE tjerë (për LOT 2 - RSM dhe LOT 4 -B CORP),i kemi kërkuar sqarime me shkrim AK-se përmes e-mailit dhe përgjigje e AK-se është se pas kërkesës se dokumenteve para dhënies e kemi vërejtur se ka pasur gabim aritmetik mbi 2% ne kalkulim dhe për këtë arsye nuk e kemi shpërblyer GOE GASHI EG dhe Ibrahim Kurrumeli – Lipjan, por dy OE e tjerë sipas Lot-eve (LOT 2 dhe LOT 4).

Poashtu kemi kërkuar sqarime nga AK-ja, se a keni dhënë ndonjë Udhëzim për plotësimin e para masës dhe përgjigje e AK-se ishte JO, nuk kemi dhënë udhëzim për plotësim.

Por ne pyetjen qe ia kemi bere AK-se se a keni bere analize për çmimin e kripës?

Përgjigje e AK-se është po, njësia kërkuese para se me vendos vlerën e parashikuar ka bere analize te çmimit te kripës! Por nuk ka dhënë sqarim me te detajuar siç i kemi kërkuar AK-se.

Ne fund edhe AK sqaron se kane anuluar LOT I, III dhe V dhe sqaron se për te evituar ndonjë shkelje lidhur me mos njohuritë OE se si te plotësohen çmimet dhe sqarimet sa me te detale për OE ne do te pajtoheshim me çdo vendim nga OSHP.

Kurse sa i përket shqyrtimit pasi qe dy Operatoret e kane totalin e njëjtë, pasi qe njeri ankues ka dhënë çmimin për njësi (për shërbim), kurse tjetri ka dhënë çmim vjetor (për 20 shërbime), prandaj mendoj qe Paneli Shqyrtues i OSHP-se duhet te konstatoj për tabelarin se a është formuluar si duhet.

Lidhur me pretendimin se OE kane ofertuar me çmime te ulëta për kripë, mendojë se çështja e analizës së çmimeve bie mbi përgjegjësi te AK-se qe te bej një analize apo hulumtim tregu ne rivlerësimin e ofertave për çmimet e ofertuar te dy OE-ve.

Poashtu mendoj se me se miri do te ishte nëse ishte qartësuar sa kg kripe e rërë do te shpenzohen për 1 shërbim, por këtë AK nuk e ka bere, prandaj kjo përgjegjësi është dhe mbetet tek AK.

Siç pretendon OE ankues se OE kane ofertuar me çmime te ulëta: për LOT 2 - 0.004 €, kurse për LOT 4 – 0.003 €.

Pra, nëse llogarisim për lot 2 - $0.004 * 1000 \text{ kg (ton)} = 4.00 \text{ €}$ apo për Lot 4 – $0.003 * 1000 \text{ kg (ton)} = 3.00 \text{ €}$

Pra, sasia 177 660 kg është e vendosur për një vit (20 shërbime), kurse sasia për një shërbim është planifikuar 8883 kg.

Kalkulim $177\,660 \text{ kg (20 shërbime)} / 8883 \text{ (kg/shërbim)} = 20$

Pra, AK ka planifikuar qe sasinë prej 177 660 kg ta shpenzon për 20 shërbime

Kjo bie mbi përgjegjësi te AK-se qe te vërtetohen çmimet!

Pretendimi ankimor nr.2

Lidhur me pretendimin e OE ankues për Listën e pajisjeve, siç është kërkuar ne FDT

Kriteri te kërkesa ne Formularin për korrigjimin e procedurës ka qene:

Kërkesa 3. Lista e pajisjeve teknike a. Kamion me mekanizëm për largimin e bores (me pllug) me hedhes te kripës - min 2 copë (vlen për te gjitha llotet) b. Luge ngarkuese- min 1 copë. (vlen për te gjitha llotet.) c. Grender për pastrim min 1 copë. (vlen për te gjitha llotet.) c. Makinë frezë për hudhjen e bores nga trotuari (min 2 cope) vlen për llot 1 dhe llot 2.,

Dëshmia 3. Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen. Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen (valide). Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim te nënshkruar dhe vulosur dhe te gjitha tjerat dëshmitë përkatëse.

OE i rekomanduar për LOT 4 – B CORP ne dosjen e tij e ka bashkangjitur listën e pajisjeve:

Kurse ne Formularin standard për korrigjim c. Grender për pastrim min 1 copë. (vlen për te gjitha llotet.)

Ne dosjen e OE-se se rekomanduar ne pajisjet e prezantuara nuk ka një pajisje apo greder siç e ka kërkuar ne kriteret e dosjes (Formulari i korrigjimit te procedurës)

Pra, sipas kërkesës se AK-se ne dosjen e OE nuk gjendet një pajisje e tille Greder për pastrim (min 1 cope).

Sipas listës se prezantuar ne dosje te OE B CORP, gjate rivlerësimit AK mund ta sqaron sipas nenit 72 te LPP-se.

Poashtu edhe te pretendimi për listën e çmimeve për LOT 4

2	Furnizimi dhe deponimi i kypës dhe rëres një muaj para sezonit dimërorë, matja e sasisë para organit mbikqyrës në deponi	kg	172,618.00	0.0030	517.85	10,356.96	20,713.92
---	--	----	------------	--------	--------	-----------	-----------

Specifikimi teknik i kërkuar për LOT 4 sipas FDT-se

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa perëndimore në Komunën e Lipjanit- Loti-4 për vitin 2022-2024
--

Përshkrimi i rrugëve	Të planifikuara						
	Gjatësi (m')	Gjerësi (m)	sipërfaqja-me asfalt m2	Sasia e hudhjes se kripes kg/m2	Ditët e planifikueme me reshje për hedhje te krypes	Sasia e hudhjes se kripës kg/m² ditore	Sasia e hudhjes se kripës kg/m² për 20 ditë
Lipjan Hallaq i Madh	4600	4	18400	0.020	20	368	7360
Kraishtë	5500	4	22000	0.020	20	440	8800
Ribari i Madh	9460	4	37840	0.020	20	757	15136
Zllakuqan	2600	4	10400	0.020	20	208	4160
Magure	4500	4	18000	0.020	20	360	7200
Pojata -Krojmiri II	2950	4	11800	0.020	20	236	4720
Medvec	2500	3	7500	0.020	20	150	3000
Harilaq i Vogël	1000	3	3000	0.020	20	60	1200
Vrelle Magures	2000	3	6000	0.020	20	120	2400
Qylagë	1000	3	3000	0.020	20	60	1200
Blinajë	7200	4	28800	0.020	20	576	11520
Dobraj e Madhe	10500	4	42000	0.020	20	840	16800
Gllanicë	2100	4	8400	0.020	20	168	3360
Gllanicë-Torin	1500	4	6000	0.020	20	120	2400

Lluga	3200	4	12800	0.020	20	256	5120
Dobraj e Vogël-Medvec	3200	4	12800	0.020	20	256	5120
Poturovc	2100	4	8400	0.020	20	168	3360
Torinë	2000	4	8000	0.020	20	160	3200
Ribari Vogël	3000	4	12000	0.020	20	240	4800
Ribari i Vogël-Torin	2000	4	8000	0.020	20	160	3200
Rufci i Ri -Hallaq i Madh	1500	4	6000	0.020	20	120	2400
Rufci i Ri	2200	4	8800	0.020	20	176	3520
Rufci i Vjeter	3500	4	14000	0.020	20	280	5600
Hallaqi Vogël	2700	4	10800	0.020	20	216	4320
Grack e Vjeter	4000	4	16000	0.020	20	320	6400
Jeta e Re	4200	4	16800	0.020	20	336	6720
Topliqan	4500	4	18000	0.020	20	360	7200
Topliqan-Grack e Vogel	2000	4	8000	0.020	20	160	3200
Grack e Vogël	3200	4	12800	0.020	20	256	5120
Bujanë	2300	4	9200	0.020	20	184	3680
Bregu i Zi	5000	4	20000	0.020	20	400	8000
Varigove	3500	4	14000	0.020	20	280	5600
Bregu i Zi -Kraishtë	1700	4	6800	0.020	20	136	2720
T O T A L I	113,210		429,340			8866.80	172,616.0

Pra, edhe kalkulimi i bere ne specifikim nga AK ka mund te krijoj huti edhe ne plotësimin e përshkrimit te çmimit.

Siç ju kemi dhënë sqarime ne pretendimin si me larte

Ne këtë LOT AK ka planifikuar 8866.80 kg kripe dhe rërë për një shërbim, kurse për 20 shërbime (1 vit) 172,616 kg.

Pra, siç pretendon OE ankues se sasia e kripës qe duhet te shpenzohet për 1 here është 8866 kg, e jo 172,616 kg, sepse kjo shume është për 20 here, nuk është për 1 here.

Kurse sa i përket çmimeve te ulëta siç pretendon OE ankues, se ka çmime te ulëta ku për LOT 4 pretendon se ka ofertuar me çmimin 3.00 € për TON, mendoj se duhet AK ti sqaroj çmimet e ofertuar ashtu siç pretendon OE ankues. Pra kjo bie ne përgjegjësi te AK-së.

Pretendimi ankimor pjesërisht i bazuar

SQARIM:

Autoriteti Kontraktues – Komuna Lipjan, ketë aktivitet e ka shpallur për 5 LOT-e.

Kurse AK i ka anuluar LOT 1, LOT 3 dhe LOT 5, kurse për LOT 2 dhe LOT 4 i ka shpërblyer me kontrate OE e lartpërmendur (OE RSM për LOT 2 dhe B CORP për LOT 4).

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE-se ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim sipas sqarimeve te lartpërmendura.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 30 shtator 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit me datën 03 tetor 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues profesional të OSHP-së.

Operatori ekonomik ankues “Gashi EG” & “Ibrahim Kurrumeli” – Lipjan me datën 30 shtator 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.


Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklarimeve të palëve se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit deklararon se procedura e shqyrtimit të ankesës përfundon në këtë fazë, ndërkaq obligohet Autoriteti Kontraktues KK Lipjan që aktivitetin e prokurimit ta rivlerësoj sipas mendimit të ekspertit shqyrtues te jashtëm profesional dhe brenda afatit 10 ditor konform LPP-së ta njoftoj panelin shqyrtues me veprimet e ndërmarra.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me

kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale – Departamenti Administrativ në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.


Kryetare e PSH-së
Kimete Gashi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK Lipjan

1x1 ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.